

20250881943

QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 47 paragrafi (6) të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 83/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17, 83/18, 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 152/19, 244/19, 275/19, 110/21, 123/22, 65/23 dhe 218/24), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 29 prill 2025, miratoi

RREGULLORE

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET E HOLLËSISHME PËR PAGESAT DIREKTE, PËRFITUESIT E MJETEVE, SHUMAT MAKSIMALE DHE MËNYRËN E PAGESAVE DIREKTE PËR VITIN 2025

Neni 1

Në Rregulloren për kriteret e hollësishme për pagesat direkte, përfituesit e mjeteve, shumën maksimale dhe mënyrën e pagesave direkte për vitin 2025 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 26/25), në nenin 2 paragrafi (2), në tabelë, në nënmasën 1.2, në kolonën „Kriteret e hollësishme dhe Shuma e pagesave direkte“, pika 4 ndryshohet dhe është si vijon:

„Përfitues të kësaj nënmase janë edhe ekonomitë bujqësore që janë përfituese të nënmasës 1.1 të kësaj rregulloreje, të cilat prodhimin e tyre të grurit dhe elbit e kanë përdorur për nevoja vetjake për ushqimin e bagëtisë të regjistruar me numër regjistrimi të fermës në Regjistrin e mbarështuesve të kafshëve në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, si dhe ekonomitë bujqësore që prodhimin e tyre organik të grurit dhe elbit e kanë shitur te mbarështues të certifikuar organikë ose në tranzicion, të regjistruar me numër regjistrimi të fermës në Regjistrin e mbarështuesve të kafshëve në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë. Numri i pranueshëm i kafshëve për sipërfaqe prej 0,7 hektarësh: një krerë gjedhë ose një njëthundrak, përkatësisht 10 dele ose dhi, përkatësisht 4 derra;“.

Në nënmasën 1.6, në kolonën „Kriteret e hollësishme dhe Shuma e pagesave direkte“, pas pikës 6 shtohet pikë e re 7, e cila është si vijon:

„– Shuma e mbështetjes për lajthi është 13.000,00 denarë për hektar;“.

Në pikën 7 fjala „lajthi“ shlyhet.

Nënmasa 1.7 ndryshohet dhe është si vijon:

	Pagesa direkte shtesë nga nënmasa 1.6 për fruta të dorëzuara në kapacitete	- Përfitues të kësaj nënmase janë të gjitha ekonomitë bujqësore që kanë sipërfaqe
--	--	---

	përpunuese ose te blerës të regjistruar	të mbjella me këto lloje frutash: mollë, pjeshkë, vishnje, mjedër, manaferrë, aroni, goji berry, kajsi, luleshtrydhe, shegë dhe lajthi, të cilat janë përfituese të nënmasës 1.6 të kësaj rregulloreje dhe janë të regjistruara në Regjistrin e Vetëm të Ekonomive Bujqësore; - Prodhimi i realizuar i pjeshkës, vishnjës, mjedrës, manaferrës, aronisë, goji berry, kajsisë, luleshtrydhes dhe shegës duhet të jetë dorëzuar në kapacitete përpunuese për fruta drejtpërdrejt ose përmes një blerësi të regjistruar, në periudhën nga 26 dhjetor 2024 deri më 25 dhjetor 2025, të regjistruar në Regjistrin e blerësve të produkteve bujqësore – fruta; - Prodhimi i realizuar i mollës duhet të jetë dorëzuar në kapacitete përpunuese ose te blerës i regjistruar, drejtpërdrejt ose përmes një blerësi të regjistruar, në periudhën nga 15 gusht 2024 deri më 31 janar 2025, të regjistruar në Regjistrin e blerësve të produkteve bujqësore – fruta; - Prodhimi i realizuar i lajthisë duhet të jetë dorëzuar te blerës të regjistruar në periudhën nga 15 shtator 2024 deri më 31 mars 2025, të regjistruar në Regjistrin e blerësve të produkteve bujqësore – fruta; - Lartësia e mbështetjes për kulturat nga alineja 1 e kësaj
--	--	--

		nënmase është 3 denarë për kilogram për të gjitha kulturat frutore, përveç mjedrës dhe lajthisë, ku mbështetja është 5 denarë për kilogram; - Lartësia e mbështetjes për mollën është 2 denarë për kilogram; dhe - Rendimentet maksimale për kultura të veçanta frutore për realizimin e kësaj nënmase janë të përcaktuara në Shtojcën 6, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
--	--	---

Në nënmasën 1.11, në kolonën “Kriteret më të detajuara dhe Lartësia e pagesave direkte”, alinea 5 ndryshohet dhe formulimi i saj është si vijon:

“- Sasia minimale e pranueshme e certifikuar për material faror para-bazë, bazë dhe gjenerata e parë (C1) për grurë, elb, oriz dhe tritikale është 2,5 ton për hektar sipërfaqe të deklaruar, por jo më shumë se 8 ton për hektar;”.

Në nënmasën 1.12, në kolonën “Kriteret më të detajuara dhe Lartësia e pagesave direkte”, në alinejën 1 pas fjalëve “jo më vonë se 1 mars 2025” shtohen fjalët “, si dhe deri më 31 maj 2025”.

Në alinejën 2 shuma “15” zëvendësohet me shumën “5”.

Në paragrafin (3), në tabelë, në nënmasën 2.1, në kolonën “Kriteret më të detajuara dhe Lartësia e pagesave direkte”, alinea 1 ndryshohet dhe formulimi i saj është si vijon:

„- Përfitues të kësaj nënmase janë ekonomitë bujqësore që mbarështojnë gjedhë, i kanë të shënuara dhe të evidentuara në Regjistrin e vendmbajtjeve të gjedhit dhe të njëjtat do t’i mbajnë së paku deri më 30 nëntor 2025, si dhe prodhimin vetanak të qumështit e kanë dorëzuar te një blerës i regjistruar i qumështit të papërpunuar si përfitues të nënmasës 2.3 të kësaj rregulloreje ose kanë shitur apo therur gjedhë gjatë vitit 2025 në kapacitete të regjistruara therëse të regjistruara në Regjistrin e objekteve të miratuara për prodhimin e ushqimit me prejardhje shtazore;”.

-Në nënmasën 2.4, në kolonën “Kriteret më të detajuara dhe Lartësia e pagesave direkte”, në alinejën 2, fjalët „prerë-punues kapacitetet“ zëvendësohen me „kapacitetet e regjistruara therëse“.

-Në nënmasën 2.6, në kolonën “Kriteret më të detajuara dhe Lartësia e pagesave direkte”, në alinejën 2, fjalët „prerë-punues kapacitetet“ zëvendësohen me „kapacitetet e regjistruara therëse“.-Në nënmasën 2.11, në kolonën “Kriteret më të detajuara dhe Lartësia e pagesave

direkte”, në alinejën 1, fjalët “kapacitete përpunuese” zëvendësohen me fjalët “kapacitete të regjistruara therëse”.

-Në nënmasën 2.12, në kolonën “Kriteret më të detajuara dhe Lartësia e pagesave direkte”, në alinejën 1, fjalët “kapacitete përpunuese” zëvendësohen me fjalët “kapacitete të regjistruara therëse”.

Neni 2

Shtojca 6 zëvendësohet me një Shtojcë të re 6, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 3

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Nr. 50-3247/24
29 Prill 2025
Shkup

Zëvendëskryeministri i Qeverisë
së Republikës së Maqedonisë së Veriut
Ljupço Dimovski, n.p

Shtojcë 6

Rendimentet maksimale për kultura të veçanta frutore për hektar

Lloj fruti	Ton për hektar
Mollë	60
Pjeshkë	35
Vishnje	15
Mjedër	10
Manafërë	25
Aroni	10
Goji berri	10
Kajsi	35
Luleshtrydhe	25
Shegë	25
Lajthi	3,5